




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr. 61/2023

Data: 27.06.2023

Mbështetur në nenet 26, 27 dhe çështjet procedurale të përcaktuara sipas nenit 11, 13, 15, 16, 17, 18, 35, 36, 39, 51 dhe 55 paragrafi 1.5 të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, Komisioni i Autoritetit i Konkurrencës, në mbledhjen e datës 27.06.2023, mori këtë:

VENDIM

I. LEJOHET Përqendrimi i ndërmarrjeve: CDI-IP Sh.P.K. lidhur me blerjen e 100% të aksioneve mbi IP-KOS Sh.P.K.

CDI-IP Sh.P.K. është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli të regjistruar në Rr. "Pennsylvania", Marigona Residence, Nr. 41, 10000 Prishtinë, Kosovë, e regjistruar pranë Agjencisë të Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës ("ARBK") me numër unik identifikues 812003507. CDI-IP është një kompani e re, pa aktivitete ekonomike dhe qarkullim në tregun e Republikës së Kosovës e cila do të ushtrojë rolin e aksionarit në IP-KOS Sh.P.K.

IP-KOS SH.P.K. është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli të regjistruar në Rr. "Pennsylvania", Marigona Residence, Nr. 41, 10000 Prishtinë, Kosovë, e regjistruar pranë ("ARBK") me numër unik identifikues 810834673, aktiviteti primar i kompanisë është: tregtia me pakicë e karburanteve për automjete në dyqane të specializuara.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguajë taksën administrative prej 100.00 € me shkronja (*njëqind euro*) dhe Autorizimin për realizimin e përqendrimit në përputhje të nenit 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 20 të udhëzimit Nr. 06/2012, bëhet pagesa në vlerë prej 3,000.00€ me shkronja (*tre mijë*) Euro.

III. Pas lejimit të Përqendrimit mbi blerjen e 100% të aksioneve të IP-KOS Sh.P.K. Autoriteti do ta monitoroj sjelljet e ndërmarrjes CDI-IP Sh.P.K.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 14.03.2023, me Nr. Prot. 104/23-01/H ka pranuar kërkesën për njoftim të Përqendrimit përmes znj. Mrika Gashi, Përfaqësuese Ligjore e autorizuar nga ndërmarrja CDI-IP Sh.P.K. (blerës) lidhur me Fitimin e Kontrollit mbi IP-KOS Sh.P.K. (shitës).

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës;
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 04.04.2023;
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në ueb faqen e AKK-së me datë 23.03.2023;
4. Më datë 23 janar 2023, palët kanë nënshkruar Marrëveshjen për shitblerje të aksioneve; me të cilin ndërmarrja CDI-IP Sh.P.K do të blej 100% të aksioneve të IP-KOS Sh.P.K;
5. Konkluzioni i datës 04.05.2023 me nr. prot. 196/23-02/D për fillimin e procedurës për vlerësimin e përqendrimit.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a) Qarkullimi në tregun e brendshëm, kalon shumën 3,000,000€;
- b) Ndërmarrja CDI-IP Sh.P.K do të blej 100% të aksioneve nga IP-KOS Sh.P.K.;
- c) Kontrata e nënshkruar ndërmjet palëve, me datë 23 janar 2023;
- d) Kërkesa për përqendrim është bërë për arsye se blerësi dhe shitësi janë prezent në territorin e Republikës së Kosovës.

Vlerësimi i Konkurrencës:

Tregu Relevant - Struktura e tregut do të mbetet e pandryshuar në Republikën e Kosovës, sepse vetëm struktura aksionare e kompanisë do të ndryshoj.

Tregu i produktit - Sektori i Karburanteve për automjete në dyqane të specializuara.

Tregu gjeografik - konsiderohet, territori i Republikës së Kosovës.

Tregjet e Prekura - Transaksioni, nuk do të shkaktojë ndonjë rritje të pjesës së tregut, pra do ta ruaj pozicionin aktual në tregun relevant në Republikën e Kosovës.

Transaksioni nuk krijon tregje të prekura, pasi që transaksioni, do të kaloj nga shitësi tek blerësi me strukturë të njejtë të aksioneve të kompanisë.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Autoriteti me datë 04.05.2022, ka pranuar nga ndërmarrja IP-KOS Sh.P.K. pasqyrat financiare për vitet 2021 dhe 2022, ndërmarrje në vitin 2021 kishte qarkullim financiar

2

68,091,274€, ndërsa në vitin 2022 kishte 99,439,772€, e që në fazën e parë të vlerësimit të përqendrimit mungonin këto pasqyra, sipas nenit 16 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 raporti vjetor financiar i pjesëmarrësve në përqendrim për vitin paraprak financiar. Nga njoftimi jo i plotë i përqendrimit, se kërkesës, nuk ka qenë e mundur të vërtetohet se në rastin konkret janë përmbushur kushtet e kërkesës për lejimin e përqendrimit, për të çmuar se ky përqendrim mund të pengoj konkurrencën efektive në tregun përkatës, sidomos me krijimin ose forcimin e pozitës dominuese, me këtë rast nga analiza e tregut të derivateve të naftës për vitet 2020/21, ndërmarrja IP-KOS Sh.P.K. ka rreth 11% pjesëmarrje në tregun e derivateve të naftës.

Vlerësimi i Konkluzionit i datës 04.05.2023 me nr. prot. 196/23-02/D mbështetet nga dokumentet dhe të dhënat e pranuar nga parashtruesi i kërkesës, me këtë rast nga të dhënat e ofruara nga ndërmarrja IP-KOS Sh.P.K. ka 36 pika, të cilat janë të hapura përveç dy pikave të cilat ende nuk janë hapur në këto lokacione: Drenas Qendër dhe Mendare.

Lidhur me dyshimin se janë realizuar transaksionet financiare pa e marrë vendimin për lejimin e përqendrimit (përveç kaparit), grupi i punës kanë kontrolluar Kontratën për Shitjen dhe Blerjen e të Gjithë Kapitalit Aksionar të Emëruar të IP-KOS Sh.P.K. i datës 21.01.2023, e vërtetuar pranë noterit me datën 23.01.2023 me Nr. i LRP. 306/2023.

Kontrata për shitblerjen është analizuar, me të cilin është vërtetuar se në janar të vitit 2023, ndërmarrja CDI-IP Sh.P.K. ka bërë transaksion financiar ndërmarrjes IP-KOS Sh.P.K, në emër të kaparit shumën prej 500,000.00€ (*pesëqind mijë euro*), ndërsa në emër të shitblerjes së aksioneve shumën prej 5,500,000.00€ (*pesë milion e pesëqind mijë euro*) totali i transaksionit është në shumën prej 6,000,000.00€ (*gjashtë milion euro*). Ndërmarrja CDI-IP Sh.P.K. shuma e borxhit të mbetur prej 5,937,662.00 (*pesë milion e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtë qind e gjashtëdhjetë e dy euro*) ndërmarrja IP-KOS Sh.P.K. sipas kontratës ka për obligim ta përfundoj në janar të vitit 2025, që është në përputhje me nenin 15 paragrafi 2 në të cilin potencohet çështja e transaksionit në të cilin theksohet se: Kërkesa për lejimin e përqendrimit parashtrohet pas lidhjes së kontratës me të cilën fitohet kontrolli i ndërmarrjes ose pas bërjes publike të përqendrimit dhe para realizimit të përqendrimit,

Autoriteti pas konkluzionit për vlerësimin e përqendrimit me fjalë, ka konstatuar se aplikuesi nuk ka ndërmarr asnjë veprim që do ketë efekte ndaj palëve të treta, as nuk është angazhuar në biznesin e ndërmarrjes sipas procedurave në fuqi.

Nga marrëveshja dhe transaksioneve bankare të siguruara sipas konkluzionit i datës 04.05.2023 me nr. prot. 196/23-02/D, konstatojmë se transaksioni i shitblerjes së aksioneve nuk ka ndodhur, procesi pritet të ekzekutohet sipas dispozitave të kontratës në mes te palëve kontraktuese në vitin 2025.

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Kosovës, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se palët në përqendrim janë prezent në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e

Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk do të kenë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës.

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AUTORITETI I KONKURRENCËS
Komisioni

Neime Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Nënkryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare

Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva